

SIGAL UNIQA INVEST

Informacion Mujor – Janar 2025

Emri i Fondit	Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur SIGAL
Struktura Ligjore	Fond Pensioni*
	Licencuar nga AMF me licencë nr. 2, datë 30.03.2011
Administrimi i Fondit	SIGAL UNIQA INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Sh.a.
Themeluar	Janar 2006
Monedha	Lekë
Banka Depozitare	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.
Auditues	Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k.

*Rregulluar nga Ligji nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit Privat"

Komision në Hyrje	0%
Komision në Dalje	0%
Komision Vjetor Administrimi	1.50%
Penalitet për tërheqje të parakohshme	Sipas Rregullores së AMF
Komision Performance	0%
Shuma fillestare e kuotës	1.000 Lekë
Kontributi fillestar minimal	1.000 Lekë
Kontributi minimal pasues	1.000 Lekë

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objektivat e Investimit

Fondi i Pensionit ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në banka të nivelit të dytë të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Janar 2025

Vlera Neto e Aseteve	3,184,923,103.04 Lekë
Numri i anëtarëve	15,214
Çmimi i Kuotës	1,728.8037 Lekë
*Fitimi vjetor (31/12/24-31/12/2025)	4.23 %

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

** Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.

Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL**, treguesi është në nivelin 1, ose nivel më i ulët i rrezikut.

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portofoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Treguesi është i bazuar në të dhënat historike të 5 viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

Performanca e Fondit

Performanca e Fondit deri në 31.01.2025



Gjatë muajit Janar 2025 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për muajin e parë 2025 ka rezultuar 0.38%.

Fitimi vjetor neto (%) për 12 muajt e fundit (Periudha: 31/01/2024-31/01/2025) ka shënuar nivelin 4.23%.

Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.


Performanca vjetore (%)					
	2020	2021	2022	2023	2024
Fondi	3.26	3.37	3.29	3.52	4.16

Rritja e Vlerës Neto të Aseteve (%)			
	2021- 2022	2022- 2023	2023- 2024
Fondi	21.68	11.88	13.26



*** Të dhënat e mësipërme janë të ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbëjnë garanci për të ardhmen.

Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një rritje e rendimentit për titujt për të cilët janë organizuar ankande gjatë këtij muaji. Raporti mesatar i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.79, një rënie nga 1.87 raport mbulimi gjatë muajit dhjetor 2024.

Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.04 % nga 3.38% me një rënie prej 0.34 % krahasuar me ankandin e muajit dhjetor 2024.

Obligacioni referencë 3 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.45 % nga 3.52 % me një rritje prej 0.07% krahasuar me ankandin e muajit dhjetor 2024.

Obligacioni referencë 5 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.80 % nga 3.95 % me një rënie prej 0.15% krahasuar me ankandin e muajit dhjetor 2024.

Obligacioni 10 vjeçar ka rezultuar me rendiment 5.25 % nga 5.93 % me një rënie prej 0.68% krahasuar me ankandin e muajit nëntor 2024.

Gjatë muajit janar 2025 pati një emetim të ri, Testim Tregu i Obligacionit 20 vjeçar i cili rezultoi me një rendiment 6.78%.

Për obligacionet me afat 7 dhe 15 vjeçar nuk është zhvilluar ankand në muajin Janar 2025, ndaj i referohemi interesave të emetimeve të fundit respektivisht 4.85% ankandi i obligacionit 7 vjeçar në nëntor 2024 dhe 6.41% ankandi i obligacionit 15 vjeçar i muajit nëntor 2024.

Informacion Praktik

Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 156, 157 dhe 158 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL**. Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL** dhe në <https://fondisigal.com.al/>

Kontakt:

Rr. "Ukraina e Lirë", Tiranë

Email: info@fondisigal.com.al

Tel: +355 (0) 44 511 666